



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 993/5 prot.,

Tiranë, më 23.04.2021

VENDIM

Nr. 32, datë 23.04.2021

PËR

NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN Nr.7, DATË 14.01.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË SIPAS KRITERIT EKONOMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021, QË STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 51 të statutit të UMT-së, Kodit të Procedurave Administrative Të Republikës së Shqipërisë, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë." e ndryshuar dhe materialin e Administratorit të UMT-së nr.163/1 prot, datë 19.04.2021 "Mbi një rregullim në vendimin nr.7, datë 14.01.2021, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Në listën e studentëve të përcaktuar në pikën 1 (një) të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.7, datë 14.01.2021 "Për miratimin e listës së studentëve, që përfitojnë bursë sipas kriterit ekonomik ...", të saktësojë mbiemrin e studentes nga Shqipe Luan Koka në Shqipe Luan Sheta.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**KRYETARI
FLORIAN TOTI**

Punoi: A.Berdynaj, Drejtues
Numri i kopjeve: 3(tre)

